



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



P R O C E S V E R B A L

PRANUAR

06 / 01 /

2025

I

Nj. Org.

Numër

Shtojca

Vlera

01 -

060104 - 665

TUBIMIT TË DYTË ME PUBLIKUN

Datë: 26.12.2024
Ora: 14:00
Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Tubimi me publikun në lidhje me aktivitetet e komunës për vitin 2024, u mbajt me datë 26 dhjetor 2024. Këtë tubim e hapi Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, **Bekim Dobra** dhe të pranishëm ishin: **Tubimin e dytë publik për punën njëvjeçare të vitit 2024.**

Ramiz Lladrovci	Kryetar i Komunës
Nexhmedin Gruda	Drejtësor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergencë
Petrit Gashi	Drejtësor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Muhamed Gjoka	Drejtësor i Drejtorisë për Arsime
Lumnije Krapi	Drejtësor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Anita Avdullahu	Drejtësor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Albulena Saliuku	Drejtësor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
Endrit Gllareva	Drejtësor i Drejtorisë për Infrastrukturë Lokale
Arian Krasniqi	Drejtësor i Drejtorisë për Xheodezi, Pronë dhe Kadastër



Në këtë tubim publik, në koordinim me Kryetarin e Komunës, është përcaktuar ky rend dite:

1. **Prezantimi i Raportit Vjetor të Punës së Kryetarit të Komunës**
2. **Informim rreth Projekteve dhe Aktivitetave në Komunën e Drenasit**
3. **Pyetje dhe Përgjigje**

Kryetari i Komunës, z. Ramiz Lladrovci, falënderoi qytetarët për bashkëpunim, të cilët e kanë prioritet të mirën e përgjithshme dhe të komunitetit që kujdesen për mbarëvajtjen e punës tonë, duke na njoftuar me nevojat, për cilësinë e punëve të kryera, për vërejtjet dhe ankesat.

Në veçanti falënderoi administratorët e vendbanimeve që pa kursyer kohën, kanë bashkëpunuar me ekzekutivin për realizimin e synimeve të përbashkëta dhe mirëqenien e qytetarëve. Kërkoi po ashtu të jenë si deri më tani, bashkëpunues por edhe mirëkuptues, të jenë ankues por edhe mirënjoyës që së bashku po e bëjmë më të mirën për qytetarët tanë.

Gjithashtu, shprehu falënderime për drejtorët e drejtorive, stafin e Kabinetit, të cilët me përkushtim po zbatojnë punën e planifikuar, duke respektuar buxhetin dhe afatet për realizimin e projekteve kapitale. Po ashtu, bëri një njoftim të shumëpritur: Komuna e Drenasit, për të gjashtën herë, renditet e para në grantin e performancës.

Ndër tjerash, të pranishmëve ju drejtua me këtë fjalim:

Të nderuar qytetarë të Drenasit,

Të nderuar administratorë të vendbanimeve,

Së pari, ju falënderoj për mbështetjen dhe mirëkuptimin që tregoni në këto periudha sfiduese. Jam sot këtu për të raportuar mbi punën tonë të përbashkët, arrijet, si dhe për të ndarë me ju sfidat që kemi hasur gjatë këtij gjashtëmuajori të dytë të vitit.

Pavarësisht angazhimit tonë dhe përkushtimit për të realizuar projekte në shërbim të qytetarëve, disa sfida kanë penguar zhvillimin e plotë të punës sonë. Një ndër to ka qenë bllokimi i Kuvendit Komunal për më shumë se katër muaj. Ky bllokim ka ndikuar negativisht në një prej arrijjeve më të rëndësishme të komunës sonë – Grantin e Performancës, për vitin e ardhshëm.

Komuna e Drenasit, që për vite me radhë ka qenë lider në performancë në nivel vendi, vitin e ardhshëm do të përballet me pasoja të rënda për shkak të mungesës së funksionimit të Kuvendit. Ky bllokim, i shkaktuar nga papërgjegjësia dhe bojkoti i disa grupeve politike, do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në buxhetin tonë për vitin e ardhshëm. Humbja e fondeve nga Granti i



Performancës, që arrin në miliona euro, do të jetë një goditje e madhe për komunën tonë dhe për projektet kapitale që do të mund të realizoheshin me këto mjete.

Për më tepër, edhe kontrata kolektive, e cila është një obligim i nivelit qendror, ka sjellë pasoja të rënda për buxhetin tonë. Përmes përmbaruesve, janë marrë mjete financiare që ishin planifikuar për projekte të rëndësishme kapitale, duke e bërë edhe më të vështirë realizimin e planeve tona. Megjithatë, ne nuk jemi dorëzuar dhe kemi vazhduar me përkushtim maksimal të realizojmë projekte që prekin drejtpërdrejt jetën tuaj:

- Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimeve, një projekt madhor që përfshin 18,000 metra dhe ka përmirësuar ndjeshëm kushtet e jetesës në shumë vendbanime.
- Ndriçimi publik, që është zgjeruar me 58,197 metra të reja ndriçim, duke sjellë më shumë siguri dhe cilësi jete.
- Funksionalizimi i ujësjellësit, ku janë realizuar mbi 1,000 kyçje të reja në Zabel të Ulët, Korroticë të Ulët, Shtuticë, Polluzhë dhe Komoran.
- Asfaltimi dhe rehabilitimi i rrugëve, duke përfshirë segmente kryesore në qytet dhe fshatra si Poklek, Llapushnik, Likoshan, Sankoc dhe shumë të tjera.
- Ndërtimi i parkut dhe shtigjeve për këmbësorë në parkun e pishave në Kamenicë, një hapësirë rekreative e re për qytetarët tanë.
- Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit “Fehmi e Xhevë Lladrovci”, që është drejt përfundimit dhe do të shërbejë si simbol i përbashkët i komunës sonë.
- Riparimi i rrugëve përmes rehabilitimit të gropave dhe mirëmbajtjes dimërore në gjatësi prej 512.5 km.
- Zgjerimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik, duke përfshirë 217 km të reja.
- Rregullimi i rrethojave për tri parcela varrezash në Çikatovë të Vjetër dhe Terstenik.

Të dashur qytetarë,

Këto sfida janë dëshmi e vështirësive që hasim në qeverisjen tonë, por edhe e përkushtimit tonë për të mos ndalur së punuari për të mirën e Drenasit. Ne nuk do të lejojmë që papërgjegjësia e të tjerëve të na ndalë në përbashjen e detyrimeve tona ndaj jush.

Së bashku me ekipin tim, do të vazhdojmë të punojmë për të përmirësuar jetën e qytetarëve tanë dhe për të siguruar që çdo cent i buxhetit të komunës të shpenzohet në shërbim të nevojave tuaja.



Përkundër pengesave, unë jam i bindur se me mbështetjen tuaj do të vazhdojmë të ndërtojmë një Drenas më të mirë për të gjithë.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe besimin tuaj të vazhdueshëm!

Me respekt,

Lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për vitin 2024, pjesëmarrësit parashtruan kërkesa, ofruan sugjerime dhe dhanë komentet e tyre.

Kërkesat e parashtruara, sugjerimet dhe komentet e dhëna kryesisht u bënë nga:

Habib Gashi	Administrator i fshatit Nekoc
Albenit Ramadani	Banor i fshatit Nekoc
Zekë Kluna	Administrator i fshatrave Poklek i Vjetër dhe të Ri, si dhe Vasilevë
Semedin Kiçina	Administrator i fshatit Baicë
Xhafer Dobërdolani	Administrator i fshatit Korroticë e Epërme
Ylber Fana	Banor i fshatit Nekoc

Kërkesat e parashtruara nga të lartpërmendurit ishin kryesisht të natyrës së ngjashme, duke përfshirë: ndriçimin publik, infrastrukturë rrugore (mirëmbajtja, shtrimi dhe asfaltimi i rrugicave dhe trotuareve), ujësjellës dhe kanalizim. Sugjerimi kishte të bënte me pezullim të punimeve me afat të caktuar, dhe komentet kryesisht ishin të llojit të përgëzimit për punën e bërë deri më tanë.



Kërkesat, sugjerimet dhe komentet e paraqitura në formë tabelore:

Lloji:	Total:	Statusi:
Kërkesa	4	Pranohen
Përbajtja	Përgjigje	
<ul style="list-style-type: none"> • Ndriçimi publik, • Infrastrukturë rrugore [mirëmbajtja, shtrimi dhe asfaltimi i rrugicave dhe trotuareve, nënkalimi] • Ujësjellës [shtrimi i gypave, lidhjet], dhe • Kanalizim [rrjedhja e ujërave jashtë kanalizimit] 	<p>Të gjitha kërkesave të parashtruara, kryetari i komunës së Drenasit, z. Ramiz Lladrovci në bashkëkoordinim me drejtoritë përkatëse u dha përgjigje, duke theksuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndriçimi publik - është pothuajse i përfunduar mbi 96%, tashmë shumica e vendbanimeve kanë ndriçim. ▪ Infrastruktura rrugore - është në drejtimin e duhur; punohet me intensitet të lartë dhe të gjitha projektet po zhvillohen sipas planit të urbanizimit të paraparë. ▪ Ujësjellësi - shumica e punimeve janë përfunduar nga komuna; janë instaluar gypa të rinj dhe pompa. Ka disa sfida në disa fshatra, por pritet që ato të zgjidhen së shpejti. ▪ Kanalizimi - Do të shqyrtohet çështja e kanalizimit në fshatin Nekoc, ku edhe do të bëhet inspektimi nga terreni se prej nga ka ardhur prishja dhe sigurisht që drejtoria përkatëse do ta rregulloj këtë çështje. 	

Lloji:	Total:	Statusi:
Sugjerime	1	Pjesërisht pranohen
Sugjerimet	Përgjigje	
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të sanohen gropat kryesisht në rrugën përfshatin Nekoc, si dhe të drejtohen shtyllat elektrike të tensionit të lartë. 	<p>Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës: Sigurisht që do ta kemi parasysh sanimin e gropave. Sa i përket shtyllave elektrike të tensionit të lartë, ato janë nën administrimin e KEK-KEDS, dhe do të sigurohem që t'i kontaktojmë.</p>	



Lloji:	Total:	Statusi:
Komenti	1	Pranohen
Komenti		Përgjigje
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Është një model për punën, transparencën dhe korrektësinë edhe për komunat e tjera. ▪ Deri më tani keni bërë një punë të shkëlqyer dhe uroj që edhe në të ardhmen të vazhdoni po njësoj. 		Ramiz Lladrovi, Kryetar i Komunës: Falënderoj administratorët e vendbanimeve që pa kursyer kohën, kanë bashkëpunuar me ekzekutivin për realizimin e synimeve të përbashkëta dhe mirëqenien e qytetarëve. Kërkoj po ashtu të jenë si deri më tani, bashkëpunues por edhe mirëkuptues, të jenë ankues por edhe mirënjojës që së bashku po e bëjmë më të mirën për qytetarët tanë.

Pas përfundimit të sesionit të kërkesave, pyetjeve, sugjerimeve dhe komenteve të këtij tubimi, Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, e shpalli tubimin të mbyllur.

Tubimi me publikun përfundoi në ora 15:00.





Shtojca - 1

Procesverbalit i bashkëngjitën edhe:

Faqe	Emërtimi
8	Paraqitja e pjesëmarrësve në formë tabelore
9	Ftesa dhe njoftimet përcjellëse në lidhje me Tubimin e Dytë me Publikun
10	Njoftimi në gjuhën shqipe
11	Njoftimi në gjuhën serbe
12 - 13	Lista e pjesëmarrësve ne Tubimin e Dytë me Publikun
14 - 16	Foto nga Tubimi i Dytë me Publikun



Paraqitura e pjesëmarrësve në formë tabelore



Ftesa dhe njoftimet përcjellëse në lidhje me Tubimin e parë me Publikun

Ftesa dhe njoftimet përcjellëse në lidhje me Tubimin e Dytë me Publikun janë publikuar edhe në kanalet zyrtare të komunës së Drenasit, gjithmonë brenda afateve ligjore.

Vegëzat:

Ueb-faqen zyrtare të Komunës së Drenasit: <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2024/12/Ftesa-per-tubimin-e-dyte-me-publikun-2024.pdf>

Platformën qeveritare për konsultime publike: <https://konsultimet.rks-gov.net/meetingsList.php>

Rrjetet sociale-Facebook: <https://www.facebook.com/share/p/18a8RZsrA8/?mibextid=wwXIfr>



Njoftimi në gjuhën shqipe

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	09/12/2024		
Nj. Org.	Numër	Shtoj	Viera
01	060101-58471		



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Në vështrim të nenit 68, Kreu i IX- Demokracia e Drejtëpërdrejtë dhe Mekanizmat e Pjesëmarrjes së Qytetarëve, pika 68.1, 68.2 dhe 68.3 që ka të bëjë me informimin publik dhe konsultim të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 21, 22, 23, 24, 25 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 7 pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Rregullores Komunale për Transparencë si dhe nenit 17 të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovcit:

ORGANIZATION Tubim me publikun

Të enjten më datën 26.12.2024 duke filluar në orën 14:00.

Tubimi me publikun do të mbahet në Sallën e Kuvendit dhe ftohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara të Komunës, të marrin pjesë në këtë Tubim Publik duke ju përmbytjatur termini të caktuar më lart.

Në këtë Tubim me publikun përfaqësuesit e Komunës do të informojnë pjesëmarrësit për aktivitetin e Komunës për gjashtëmujorin e dytë të këtij viti, për të arriturat, vështirësitetë dhe synimet, si dhe investimet kapitale, ndërsa pjesëmarrësit mund t'u shtrojnë pyetje dhe të japid propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për gjashtëmujorin e dytë dhe çështje tjera në interes të qytetarëve të Komunës.

Me respekt,



KRYETARI I KOMUNËS
Ramiz Lladrovcit



Njoftimi në gjuhën serbe

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	09/12/2024		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/01-58471		



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas-Municipality of Drenas
Kancelarija Predsednika Opštine



Imajući u vidu član 68, Poglavlje IX – Neposredna Demokratija i Mechanizmi Učešća Građana, tačke 68.1, 68.2 i 68.3 koje se odnose na javno informisanje i konsultacije Zakona o Lokalnoj Samoupravi, članovi 21, 22, 23, 24, 25. Statutom Opštine Glogovac, kao i članom 7. tačka 1, 2, 3, 4, 5 i 6 Opštinske Uredbe o Transparentnosti, kao i član 17 Administrativnog uputstva o Otvorenoj Administraciji u Opštinama, Predsednik Opštine Glogovac, Ramiz Lladrovci:

O R G A N I Z U J E Okupljanje sa publikom

U Četvrtak datumom **26.12.2023** sa početkom u **14:00** časova.

Sastanak sa javnošću biće održan u Sali Skupštine i pozivaju se svi građani i zainteresovani subjekti opštine da učestvuju na ovom Javnom Skupu poštujući gore navedeni rok.

Predstavnici Opštine će na ovom sastanku sa javnošću informisati prisutne o aktivnostima Opštine za drugu polovinu ove godine, o dostignućima, poteškoćama i ciljevima, kao i o kapitalnim ulaganjima, a učesnici mogu postavljati pitanja i daje predloge predstavnicima izabranih opština u vezi sa realizacijom projekata planiranih za drugo polugodište i drugim pitanjima od interesa građana opštine.

S poštovanjem,


PREDSEDNIK OPŠTINE
Ramiz Lladrovci





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas-Municipality of Drenas



Lista e pjesëmarrësve në Tubimin me Publikun, datë: 26.12.2024

Nr.	Emri	Mbiemri	Gjinia M F	Nënshkrimi
1.	Herolindë Krashnici		F	<i>Hes</i>
2.	Djelza	Bardha	F	<i>Djelza</i>
3.	Skender	Zogjfi		<i>Skender</i>
4.	Blerja	Berisha	F	<i>Blerja</i>
5.	Selim	Gashi		<i>Selim</i>
6.	Edliru	Tahiru	F	<i>Edliru</i>
7.	SAFET	Koxha	M	<i>Safet</i>
8.	Hosni	Elnaw	M	<i>Hosni</i>
9.	AFRIMI PROKSHI	PROKSHI	M	<i>Afriti</i>
10.	Ibrahim	Hajdari	M	<i>Ibrahim</i>
11.	ZUSHTRIM	BADRAKTARI	M	<i>Zushtrim</i>
12.	ERLIND	KRASNIQI	M	<i>Erlind</i>
13.	Ilir	Berilia	M	<i>Ilir</i>
14.	Arberi	Halil	M	<i>Arberi</i>
15.	ARBION	ISTOGA	M	<i>Arbion</i>
16.	ARMEND	CAKIQI	M	<i>Armend</i>
17.	HABIB GASHI	GASHI	M	<i>Habib</i>
18.	Jlber	FANA	M	<i>Jlber</i>
19.	SEMEDIN KICINKA	KICINKA	M	<i>Skicinka</i>
20.	Idriz s. Spahiu	Spahiu	M	<i>Idriz</i>
21.	XHAFORE JEBRODOLANI	KOCOTTIC E GEDERHE	M	<i>Xhafore</i>
22.	Hatem Haxhi	Jankoci	M.	<i>Hatem</i>
23.	QERIM BERSA	Gohane	M	<i>Qerim</i>
24.	Avniyl XHATI	MZIU	M	<i>Avniyl</i>
25.	SHKENDOLJE XHATI	XHATI	F	<i>Shkendolje</i>
26.	SHABAN	DORRA	M	<i>Shaban</i>

* Në këtë takim, përvjetësohet liste, do të bëhen fotografji dhe, me nënshkrimin tuaj, pajtohen që fotografitë dhe kjo listë të përdoren për komunikim zyrtar.



27.	ZEKË	Kleraq	M	<i>Zekë</i>
28.	HEDIN	TƏHİRƏ	M	<i>Hedin</i>
29.	Albanit	Dəməcləri	-	<i>Albanit</i>
30.	Luminje	Krapo	F	<i>Luminje</i>
31.	Muhamed	Göclər	M	<i>Muhamed</i>
32.	Anita	Avtuldu	F	<i>Anita</i>
33.	Ariom	Prasnyçi	M	<i>Ariom</i>
34.	PETKIT GASHI	GASHI	M	<i>Petkit Gashi</i>
35.	Nexhumedin	Cəruada	M	<i>Nexhumedin</i>
36.	Albulena	Saliuku	F	<i>Albulena</i>
37.	Artem	Həsəni	M	<i>Artem</i>
38.	Bekim	Dəbrən	M	<i>Bekim</i>
39.	ENDRİT	GLURGENYA	M	<i>Endrit</i>
40.	Vlora	Züçaku - Morina	F	<i>Vlora</i>
41.	Sadete	Zəriqi	F	<i>Sadete</i>
42.	Valdeze	Ramij	F	<i>Valdeze</i>
43.	Lumkije Kryme	- Pekay	F	<i>Lumkije Kryme</i>
44.	Hilinda Hukaj	Amir Hukay	F	<i>Hilinda Hukaj</i>
45.	Mariyona Obrni	Murad	F	<i>Mariyona Obrni</i>
46.	Eksəm	Franca	M	<i>Eksəm</i>
47.	QANIT	ELŞAHLİ	M	<i>Qanit</i>
48.	KAJTAZ	KASTRATI	M	<i>Kajtaz</i>
49.	Mənsur	Bellava	M	<i>Mənsur</i>
50.	KUSHTRIM	VECIY	M	<i>Kushtrim</i>
51.	SHUKRIE	AUZ	F	<i>Shukrie</i>
52.	ANTIGONA	BUZOZI	F	<i>Antigona</i>
53.	Bahtiye	Şəhəri	F	<i>Bahtiye</i>
54.	Iljin	Berishə	M	<i>Iljin</i>
55.	FATLINDA	ZYMBERI	F	<i>Fatlinda</i>
56.	Liridon	Berishə	M	<i>Liridon</i>
57.	FİDAN RƏXİHEKİ	Qurxu	M	<i>Fidan Rexheki</i>
58.	Ramiz Nadrəzi		M	<i>Ramiz Nadrəzi</i>
59.				
60.				
61.				
62.				

* Nə kələ takim, pərvəç kəsəj liste, do tə bəhen fotografi dñe, me nənəshkrimin tuaq, pajtoheni qə fotografitə dñe kja listə tə pərdoren pər kommunikim zyrtar.



Foto nga Tubimi i dytë me Publikun





